

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

### Të dhëna për shërbimin e kërkuar

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi limit pa TVSH në lekë	Periudha në muaj	Nr. Rojeve
1.	<i>Sherbimi i ruajtjes dhe sigurise fizike me roje private, per nevoja te Drejtorise Spitalit Rajonal Diber</i>	4 534 200	11 muaj	9

### Të dhënat për përgatitjen e ofertës ekonomike.

Oferta të shoqërohet me një analizë kostoje ku të jenë të përfshira :

-Shpenzimet për pagën e rojeve duke zbatuar ligjshmërinë që normon Shërbimi Privat i Sigurise Fizike për një sistemin të pandërprere të punës, ditet kalendarike, ligjet, vendimet dhe udhëzimet në fuqi në lidhje me pagën baze minimale mujore, llogaritjen e sigurimeve shoqerore dhe shëndetësore etj..

### Përshkrimi i godinës së institucionit:

Sherbimi do te kryhet ne te dy godinat:

1.Godina kryesore e Spitalit Rajonal Diber

2.Godina e Maternitetit dhe Pediatrie

Vendndodhja: *Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi*

### Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë do të përfshijë sigurimin e dy godinave të Spitalit Rajonal Diber (godina kryesore dhe ajo maternitet/pediatri).
- Kryerja e shërbimit do të bëhet me 2 (dy) vëndroje.
- Koha e shërbimit të jetë 24 orëshe (3 turne), për çdo ditë kalendarike;
- Të njihet dhe të respektohet rregullorja e Institucionit gjatë kohës së kryerjes së shërbimit.
- Rojet duhet të kenë në përdorim radio komunikimi dhe arme për realizimin e shërbimit të ruajtjes.
- Rojet duhet të jenë të pajisur me uniformë, sipas legjislacionit në fuqi.

## SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

**Shërbimi që kërkohet:**

*"Sherbimi i ruajtjes dhe sigurise fizike me roje private, per nevoja te Drejtorise Spitalit Rajonal Diber"*

**Afatet e ekzekutimit:**

- Afati i ekzekutimit do të jete: 11 muaj (01.02.2017-31.12.2017)

## TERMAT E REFERENCËS

### **Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:**

"Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private, për nevojën të Drejtorisë Spitalit Rajonal Diber "

### **Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimit që kërkohet :**

1. Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë do të përfshijë sigurimin e godinës kryesore të spitalit dhe godinën e maternitet/pediatri dhe të ambienteve për rreth ku ushtrohet veprimtaria dhe aktiviteti Spitalit Peshkopi nga dëmtimet, vjedhjet e mundshme si dhe sigurimin e punës normale të punonjësve të spitalit.
2. Kryerja e shërbimit të jetë 24 orë (nga ora 00.00 deri në orën 24.00) për çdo ditë kalendarike, sipas afatëve të kontratës.
3. Punonjësit e shërbimit duhet :
  - Të jenë të pajisur me uniformë me siglën dalluese të shoqërisë dhe me dokument identifikimi personal për çdo punonjës shërbimi.
  - Të jenë të pajisur me mjete ndërlidhje për komunikim, arme, dedektor, shkopinj gome dhe hekura lidhës si për parandalimin dhe për ndalimin e veprimtarisë së keqbërësve në dëm të objektit që ka në ruajtje dhe nën përgjegjësinë personale të tij.
  - Gjatë turneve të dyta dhe të treta rojet të kryejnë kontrolle çdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objektit.
  - Para marrjes së shërbimit, kontrollon objektin në prezencë të rojes dorëzuese dhe për çregullimet e konstatuara njofton përgjegjësin e rojeve dhe atë të objektit, duke bërë shënime të përkatëse në librin e shërbimit.
  - Të kontrollojë masat e sigurisë së objekteve si rrethimin, ndriçimin, gadishmërinë e sistemit të ndërlidhjes, mbrojtjes ndaj zjarrit dhe për çdo parregullësi të njoftojë me shkrim përgjegjësin e rojeve dhe atë të objektit.
  - Në rast zjarri të marrin masa për shuarjen e tij dhe menjëherë të njoftojë zjarrfikëset.
  - Kur në objekt kryhen vepra penale, roja të bëjë bllokimin e mjedisit si dhe të autorit dhe të njoftojë menjëherë organet kompetente.
  - Për marrjen e detyrës sipas grafikut duhet të paraqitet 15 minuta para orarit. Atij i ndalohet largimi nga vendi i kryerjes së shërbimit pa u zëvendësuar.
  - Ndalohet futja dhe qëndrimi i rojes në ambientet e brendshme të institucionit, përjashtuar rasteve për zbatimin e rregullores.
  - Roja gjatë kohës së shërbimit duhet të karakterizohet nga sjellja qytetare në komunikim me punonjësit, si dhe gjatë kohës së shërbimit i ndalohet përdorimi i pijeve alkoolike.
4. Në vend roje duhet të jenë: - Rregullorja e brendshme e institucionit.- Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit. -Grafiku i shërbimit. -Mjete ndriçimi në rast mungese të energjisë elektrike. -Numrat telefonike të rajoneve të policisë, zjarrfikëseve dhe të personave kryesorë përgjegjës të objektit (institucionit).
5. Shoqëria duhet të marrë përsiper zhdëmtimin 100% të dëmeve që vijnë për shkak të mos kryerjes si duhet të shërbimit, nga punonjësit e shoqërisë.